

Filimi » Kuvendi

VIDEO/ I kishte gati për veprim/ lu gjet arsenal armësh, silenciatorë e municione, arrestohet 37-vjeçari në Elbasan, pranga dhe bashkëpunëtorit (EMRAT)

20 Tetor, 2022 12:02



Madhësia e tekstit:

- Sekuestrohet arsenal armësh, silenciatorë e municione, ndersa ne pranga kane rene dy persona.
- Burime zyrtare bene me dije se behet fjale per Luis Gaxhin dhe Rigers Spahiu.
-

NJOFTIMI I POLICISE

Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan Drejtues i Parë Ardian Çipa dhe prokurori i Prokurorisë së Elbasanit Kreshnik Ajazi, në konferencë për shtyp, në lidhje me parandalimin e ngjarjeve të rënda kriminale.

Jam sot këtu, së bashku me prokurorin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për të komunikuar me ju dhe nëpërmjet jush, me publikun, për veprimet e kryera së fundi, nga strukturat policore të DVP Elbasan, në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorinë, me qëllim parandalimin e ngjarjeve të mundshme me pasoja të rënda kriminale dhe krijimin e një ambienti sa më të sigurt për qytetarët.

Sic jeni në dijeni dhe nga njoftimet për shtyp, strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorinë e Elbasanit dhe me mbështetjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, janë përfshirë në veprime të thelluara hetimore dhe operationale, për të bërë të mundur parandalimin e ngjarjeve kriminale, dokumentimin e aktivitetit të grupeve kriminale, identifikimin e anëtarëve të tyre, zbardhjen e ngjarjeve të ndodhura më parë, kapjen dhe vënien para drejtësisë të autorëve.

Në këtë kuadër, mbështetur dhe me inteligjencë informative të siguruar në kohë reale nga ana e strukturave të Hetimit të Krimit të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, duke koordinuar veprimet dhe hetimet me Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me qëllim parandalimin e një ngjarjeve të mundshme kriminale me pasoja të rënda për jetën, më datë 20.10.2022 është finalizuar operacioni policor i koduar "Prevention".

Falë marrjes në kohë të informacionit, koordinimit me Prokurorinë dhe Gjykatën, si dhe veprimeve operationale, hetimore e procedurale të autorizuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan u bë e mundur gjetja dhe sekuestrimi, në një banesë, në lagjen "Gurabardhi", të qytetit të Elbasanit, i një arsenali armësh zjarri, disa prej tyre të pajisura me silenciatorë, gati për veprim.

Konkretisht, në banesën e shtetasit Luis Gaxhi, u gjetën:

- 4 armë zjarri kallashnikovë, dy prej të cilave të modifikuara dhe me silenciatorë;
- 3 pistoleta me silenciatorë;
- 2 mina me telekomandë, të gatshme për t'u aktivizuar për shpërthim me komandim në distancë, nëpërmjet aparateve celulare;
- Kapsolla detonatore;
- Një sasi lëndë plasëse, e dyshuar "C4";
- 4 aparate celulare;
- Sasi e konsiderueshme municioni luftarak, blindshpues.

Si rezultat i hetimeve paraprake dhe dyshimeve të bazuara në prova, u arrestuan në flagrancë shtetasit:

-Luis Gaxhi, 37 vjeç, lindur dhe banues në Elbasan, i dënuar për vepra penale në fushën e narkotikëve, në Belgjikë;

Ky shtetas u arrestua për veprat penale "Sigurimi i kushteve dhe mjeteve për të kryer vrasje", "Mbajtja dhe prodhimi i armëve luftarake në sasi të mëdha" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyeshe dhe i municionit".

-Rigers Spahiu, 37 vjeç, lindur dhe banues në Elbasan, për veprat "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës" dhe "Përkrahja e autorit të krimit". Ky shtetas dyshohet si bashkëpunëtor në aktivitetin kriminal të shtetasit Luis Gaxhi.

Në momentin e gjetjes dhe sekuestrimit të provave materiale dhe veprimeve të tjera hetimore e procedurale, skuadrat xhenerie të Njësise Antieksplziv të Repartit Special RENEA, kanë bërë të mundur çaktivizimin e minave të telekomanduara, të cilat paraqisnin rrezikshmëri për jetën e banorëve dhe efektivëve të Policisë së Shtetit.

Referuar hetimeve proaktive te kryera nën drejtimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ekzistojnë indicie të bazuara në prova, se armët dhe minat e telekomanduara do të përdorshin për ekzekutimin e personave, për llogari të grupeve kriminale të evidentuara nga ana e Policisë.

Për arsye të dobisë së mbarevajtjes së hetimeve dhe dokumentimit të plotë të veprimtarisë kriminale, na lejoni të jemi të rezervuar në dhënien e informacioneve të mëtejshme.

Theksoj se Policia e Elbasanit, në bashkëpunim me Prokurorinë, gjatë operacionit të koduar "Dëshirën" që u finalizua 1 javë më parë, sekuestroi një tjetër arsenal armësh zjarri: një kallashnikov, pistoletë, granata dore dhe municion luftarak, të cilat, bazuar në inteligjencë informative, dyshohet se do përdorshin për ngjarje kriminale, për llogari të grupeve kriminale.

Përfitoj nga rasti të siguroj qytetarët e qarkut Elbasan, se strukturat e Policisë janë tërësisht të angazhuara dhe të përkushtuara për të parandaluar, evidentuar dhe goditur krimin dhe paligjshmëritë. Në këtë kuadër, ftoj përsëri qytetarët që të jenë akoma më bashkëpunues me Policinë, pasi vetëm së bashku mund të krijojmë një ambient sa më të sigurtë për qytetarët dhe aspak të sigurtë për elementet kriminale.

Për t'u bërë pjesë e grupit **"Balkanweb"** mjafton të klikoni: **Join Group** dhe kërkesa do t'u aprovohet menjëherë. **Grupi Balkanweb**

Etiketa: arrestim

TË NGJASHME

EMRI/ Shpërndante drogë, arrestohet 27-vjeçari në Fier. Në banesë i gjetën hekur kamerat trupore për policitë (Video)

20 Tetor, 2022

Në kërkim në Kombehtar, ekstradohen dytë Shqiptarë 3 shtetas të kapur në Kosovë, Kroaci dhe Itali

19 Tetor, 2022

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

VIDEO/ I riu humb jetën në komisarlat pas shoqërimt, ja vendi ku u ndalua nga patrulla e policisë

20 Tetor, 2022

Vdekja e 32-vjeçarit Lear Kurti, ekspert i kriminalistikës: Nëse nuk do ishte hekur kamerat trupore për policitë...

20 Tetor, 2022

VIDEO/Akidentimi i të miturit në Elbasan, banorët protestë: "Të merren masa për rritjen e sigurisë"

20 Tetor, 2022

Ishte dënuar nga drejtësia greke për prostitucion, kapet në doganën e Kakavjës i shumëlloqësuri shoqëtar

20 Tetor, 2022

Debat në Kuvend, Berisha: Energji elektrike po kthehet në mallim kombëtar. Reagojnë deputetët e PS

20 Tetor, 2022

VIDEO/"Boll ordhëni si ruatëni e mirë të përshirni mësimin e propagandist", Boçi për krutën: Lufta është e vërtetë, ka rënë bomba e korrupsionit në ERE

20 Tetor, 2022

VIDEO/ I riu humb jetën në komisarlat pas shoqërimt, ja vendi ku u ndalua nga patrulla e policisë

20 Tetor, 2022

Vdekja e të rrit në komisarlat/ Përfundon ekspertiza mjeko-fizore, familjarët tërheqin trupin e 32-vjeçarit. Përcillet sot për në banesën e fundit

20 Tetor, 2022

Mister vdekja e të rritit/ Burimet nga spitali i Traumës hedhin postitë versionin e AMP-së: Erdhi pajetë te ne (VIDEO)

20 Tetor, 2022

"E vështrë të flas pas dy dragëve", deputeti i PS Pas rregulljes së Krutës, të dytën e bërë qeveria me plakën e inoneratorëve

20 Tetor, 2022